



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJË  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 30 gusht 2022

Nga: Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së  
Për: Z. Mesut Serhat Dinc, Drejtor i Përgjithshëm, KESCO Sh.A  
Kopje: Z. Ferat Shala, Kryetar Komisioni për zhvillim ekonomik, tregti dhe industri  
Znj. Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë  
Z. Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit të Kosovës



Lënda: Përgjigje ndaj kërkesës së FSHU-së për shqyrtim të jashtëzakonshëm i Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal

I nderuari z. Dinc,

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) më datë 9 gusht 2022 ka pranuar aplikimin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU). Ndër të tjera, në kërkesën e saj FSHU thekson se në mungesë të rimbursimit të mjeteve të subvencionit nga Qeveria e Republikës së Kosovës të shumës prej 32.8 milion eurove për periudhën 9 shkurt – 30 qershor 2022 është tejkalluar pragu i materialitetit prej 5% siç përcaktohet në Rregullën e të Hyrave të FSHU-së, duke mundësuar kështu hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm.

FSHU kërkesën e saj e ka mbështetur edhe në situatën e krijuar në tregun e energjisë me shumicë, krizën energjetike si rezultat i rritjes enorme të çmimeve të energjisë elektrike në tregjet ndërkombëtare dhe pretendimin se çmimet e pritshme të importit për periudhën korrik-dhjetor 2022 do të arrijnë çmime shumë të larta në bursat ndërkombëtare.

ZRRE në përputhje me Rregullën për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për FSHU-në, ka analizuar me kujdes aplikacionin e FSHU-së, dhe konstaton se ngjarja e jashtëzakonshme nuk ka qenë nën kontrollin e FSHU-së, dhe se mungesa e subvencionit të Qeverisë së Republikës së Kosovës do të tejkallonte pragun e materialitetit prej 5% në të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së, e cila do të hapte Shqyrtimin e Jashtëzakonshëm të tarifave për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.

Më datë 24 gusht, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e saj me anë të vendimit nr. 21/94 të datës 24.08.2022 në bazë të interesit publik dhe interesit të përgjithshëm ekonomik, me qëllim të sigurimit të furnizimit të rregullt me energji elektrike dhe në mënyrë që të mbahet përballueshmëria e çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal, kompanisë që vepron si Furnizues i Shërbimit Publik (FSHU) i ka vendosur obligimi shtesë i shërbimit publik. Ndërsa, me anë të vendimit nr. 23/94 ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje buxhetore në shumë prej 41 milion euro lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për zbatimin e Masës 3.7 – Mbështetje në tejkallimin e krizës energjetike.



ZRRE konstaton që vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.21/94 të datës 24.08.2022, ka neutralizuar ndikimin në tejkalimin e kostove të furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e rregulluar ashtu siç janë përcaktuar me Vendimin e ZRRE-së, V\_1486\_2022 të datës 07.02.2022 dhe V\_1489\_2022 të datës 08.02.2022, dhe njëherit kanë pushuar rrethanat për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të Të Hyrave të Lejuara Maksimale të FSHU-së, respektivisht të tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejt të Shërbimit Universal.

ZRRE edhe gjatë muajve në vazhdim, do të monitoroj nga afër gjendjen e kostove të sektorit të rregulluar të energjisë elektrike dhe do të ndër marrë hapat e nevojshëm në përputhje me mandatin mandatit e saj ligjor.

Me respekt,

Ymer Fejzullahu

Kryesues i Bordit të ZRRE-së

